



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Prizren, më 25.10.2021

Me qëllim të përkrahjes së nënave lehona, Komuna e Prizrenit ka ndarë një fond prej 1,000,000,00 euro për fëmijët të cilët kanë lindur nga data 01/01/2021.

Sipas Vendimit të Asamblesë Komunale Nr.001/011-72705 të datës 21/05/2021, dhe Vendimit Nr. 001/011-141359 të datës 09 shtator 2021, Komuna e Prizrenit bën:

THIRRJE PUBLIKE

Për aplikim për mbështetje financiare për të gjithë prindërit banorë të Komunës së Prizrenit, për të gjithë fëmijët e lindur brenda vitit 2021.

Kriteret e kualifikimit:

- ❖ Prindërit duhet të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Prizrenit;
- ❖ Fëmija duhet të jetë e/i lindur nga 01.01.2021 deri në datën e aplikimit;

Sqarim: Aplikuesit që nuk e plotësojnë njërin nga këto kriteret diskualifikohen nga përfitimi! Për fëmijët e lindur pas datës së kësaj thirrje, Komuna do të dalë me udhëzime në fund të vitit!

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari për aplikim;
2. Kopje të dokumentit identifikues (për dy prindërit);
 - a) Vetëm e prindit kujdestar, në rastet kur fëmija është nën kujdesin e njërit prind
3. Ekstrakti i lindjes i fëmijës;
4. Çertifikata e Vendbanimit të aplikuesit;
5. Deklarata e Bashkësisë Familjare;
6. Konfirmimin e xhirologarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës (Njëri nga prindërit);

Vërejtje:

1. Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal përveq dokumenteve të identitetit
2. Aplikuesit që nuk dorëzojnë njërin nga dokumentet e cekura më lartë diskualifikohen nga përfitimi!

Vëmendje:

- ✓ Përfitues të kësaj ndihme do të jenë fëmijët e lindur nga 01.01.2021 deri në mbyllje të thirrjes.
- ✓ Aplikacionet që dorëzohen pas datës 05.11.2021 do të hynë në pagesë në janar të vitit 2022.
- ✓ Vlera e mbështetjes:

Fondi që Komuna ka ndarë për këtë mbështetje është 1 milion € dhe planifikohet që vlera e mbështetjes financiare për secilin fëmijë të lindur brenda vitit 2021 do të bëhet si në vijim:

1. Për fëmijën e parë (1) të lindur ndahet shuma financiare prej 250.00 euro;
2. Për fëmijën e dytë (2) të lindur ndahet shuma financiare prej 300.00 euro;
3. Për fëmijën e tretë (3) e më tepër të lindur ndahet shuma financiare prej 350.00 euro;

Sqarim: Në rast se numri i aplikimeve tejkalon vlerën e fondit të ndarë për këtë thirrje, Komuna do të zvogëlojë vlerën e mbështetjes dhe kështu fondi do të shpërndahet për të gjithë aplikuesit që i plotësojnë kriteret.

Afati aplikimit: 25 Tetor 2021 deri 05 Nëntor 2021 ora 16:00

Aplikimi bëhet në mënyrë fizike tek Objekti Administratës Komunale në sportelet nga 1 deri në sportelin 5.

Ankesa: Të pakënaqurit me Vendimin e Komisionit për vlerësimin e aplikimeve, mund të parashtrajnë ankesë 5 ditë pas daljes së listës preliminare në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit. Ankesa parashtrohet në objektin e Drejtorise për Ekonomi dhe Financa në sportelin nr. 5

FORMULARI PËR APLIKIM PËR NDIHMË FINANCIARE**PËR FËMIJËT E LINDUR NGA DATA 01.01.2021**

1. Të dhënat personale për aplikuesin (nëna ose babai)	
Emri dhe mbiemri	
Data e lindjes	
Lidhja me femiun (<i>Nëna/Babai</i>)	
Vendi i lindjes	
Numri personal	
Adresa e vendbanimit:	
Komuna	
Kontakti-Telefoni	
Numri i fëmijës sipas radhës	
Numri i llogarisë bankare	
Emri i bankës	
Emri i mbajtësit të llogarisë bankare	

2. Të dhënat personale për fëmijun	
Emri dhe mbiemri	
Data e lindjes	
Spitali ku ka lindur	
Vendi i lindjes	
Numri personal	
Komuna	

3. Dokumentet shtesë për plotësim të aplikimit	
<input type="checkbox"/>	Kopje të dokumentit identifikues (për dy prindërit)
<input type="checkbox"/>	Ekstrakti i lindjes i fëmijës
<input type="checkbox"/>	Çertifikata e Vendbanimit
<input type="checkbox"/>	Deklerata e Bashkësisë Familjare
<input type="checkbox"/>	Konfirmimin e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njëën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;

4. Deklarata e aplikuesit për vërtetësinë e dokumentacionit		
Vërtetoj se informatat e ofruara në këtë aplikacion janë të vërteta, të plota dhe të sakta me aq sa jam unë në dijeni. E kuptoj që prezantimi i gabueshëm apo lëshimi i materialit në këtë formular apo në dokumentet e tjera të kërkuara mund të më diskualifikojë nga procesi i përzgjedhjes për subvencione.		
4.1. Data dhe vendi:	4.2. Emri dhe mbiemri:	4.3. Nënshkrimi:

Vërejtje: 1. Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat dhe dokumentet e kërkuara sipas shpalljes publike nuk do të shqyrtohet